

ASSESSMENT OF THE EUROPEAN INTEGRATION PROCESS OF THE WESTERN BALKANS THROUGH SWOT ANALYSIS IN THE CONTEXT OF THE MEMBERSHIP DELAY

Gani Rashiti

Law Faculty, UKLO, Bitola, North Macedonia, ganirashiti@uklo.edu.mk

Aleksandar Jovanovski

Law Faculty, UKLO, Bitola, North Macedonia, aleksandar.jovanoski@uklo.edu.mk

Abstract: The European integration process of the Western Balkans (WB) represents one of the strategic priorities of the European Union (EU) for the stability, security and democratic development of the region. However, the continuous delay of membership and the lack of a clear time perspective have raised important dilemmas regarding the effectiveness and credibility of this process. This paper aims to assess the European integration process of the WB through a SWOT analysis, placing it in the context of the delay of membership in the EU. The methodology of the study is based on the qualitative analysis of official documents of the EU, reports of international institutions and contemporary academic literature. The results show that, despite the symbolic progress of the WB countries in the harmonization of laws and few institutional reforms, the European integration process is facing structural weaknesses such as the lack of administrative capacities, the politicization of institutions and the decline of public trust. The delay in accession itself creates serious threats, including increased Euroscepticism, the exodus of human capital and the increasing influence of external actors in the region. Moreover, the lack of a clear perspective for the countries of the region for EU membership has weakened the motivation for deep reforms and contributed to the politicization of reform processes, while the identified weaknesses in the rule of law and institutional capacities have been reinforced by the delay in integration. The paper concludes that a more credible, meritorious and predictable approach to enlargement is essential for preserving the transformative role of the EU and for guaranteeing the long-term stability of the WB.

Keywords: Euro integration, Western Balkans, SWOT analysis, membership delay

VLERËSIMI I PROCESIT EUROINTEGRUES TË BALLKANIT PERËNDIMOR PËRMES ANALIZËS SWOT NË KONTEKSTIN E VONESËS PËR ANËTARËSIM

Gani Rashiti

UKLO, Law Faculty, ganirashiti@uklo.edu.mk

Aleksandar Jovanovski

UKLO, Law Faculty, aleksandar.jovanoski@uklo.edu.mk

Abstrakt: Procesi i integritimit evropian të Ballkanit Perëndimor (BP) është një nga prioritetet strategjike të Bashkimit Evropian (BE) për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin demokratik të rajonit. Megjithatë, shtyrja e vazhdueshme e anëtarësimit dhe mungesa e një perspektive të qartë kohore kanë ngritur dilema të rëndësishme në lidhje me efektivitetin dhe besueshmërinë e këtij procesi. Ky punim synon të vlerësojë procesin e integritimit evropian të BP-së përmes një analize SWOT, duke e vendosur atë në kontekstin e shtyrjes së anëtarësimit në BE. Metodologjia e studimit bazohet në një analizë cilësore të dokumenteve zyrtare të BE-së, raporteve të institucioneve ndërkombëtare dhe literaturës akademike bashkëkohore. Rezultatet tregojnë se, pavarësisht progresit simbolik të vendeve të BP-së në harmonizimin e ligjeve dhe pak reformave institucionale, procesi i integritimit evropian përballet me dobësi strukturore siç janë mungesa e kapacitetit administrativ, politizimi i institucioneve dhe rënia e besimit publik. Shtyrja e vetë anëtarësimit krijon kërcënime serioze, duke përfshirë rritjen e euroskepticizmit, një eksod të kapitalit njerëzor dhe rritjen e ndikimit të aktorëve të jashtëm në rajon. Për më tepër, mungesa e një perspektive të qartë për vendet e rajonit për anëtarësim në BE ka dobësuar motivimin për reforma të thella dhe ka kontribuar në politizimin e proceseve të reformave, ndërsa dobësitë e identifikuara në sundimin e ligjit dhe kapacitetet institucionale janë përforcuar nga vonesa në integrim. Dokumenti arrin në përfundimin se një qasje më e besueshme, meritorie dhe e parashikueshme ndaj zgjerimit është thelbësore për të ruajtur rolin transformues të BE-së dhe për të garantuar stabilitetin afatgjatë të BP-së.

Fjalët kyçe: Integrimi evropian, Ballkani Perëndimor, analiza SWOT, vonesa e anëtarësimit

1. HYRJE

Procesi i integritimit evropian i vendeve të BP përfaqëson një nga projektet më të rëndësishme strategjike të BE në dekadat e fundit, me synimin për të garantuar stabilitet politik, zhvillim ekonomik dhe konsolidim demokratik në rajon. Që nga Samiti i Selanikut në vitin 2003, BE-ja ka riafirmuar perspektivën evropiane të BP, duke e konsideruar zgjerimin si instrument kyç për promovimin e paqes dhe sigurisë në kontinent. Megjithatë, pavarësisht angazhimeve formale dhe reformave të ndërmarra nga vendet e rajonit, procesi i anëtarësimit është shoqëruar me vonesa të vazhdueshme dhe pasiguri politike.

Vonesa e anëtarësimit të BP në BE ka prodhuar pasoja të shumta politike, ekonomike dhe shoqërore.

Vonesa e anëtarësimit ka ndikuar ndjeshëm në dinamikën e reformave të brendshme, besueshmërinë e procesit eurointegruar dhe perceptimin publik ndaj BE-së në BP. Faktorë të tillë si lodhja nga zgjerimi brenda vetë BE-së, kushtëzimi gjithnjë e më kompleks, sfidat e sundimit të ligjit, si dhe ndikimi i aktorëve të jashtëm gjeopolitikë, kanë kontribuar në një proces të fragmentuar dhe shpeshherë të paparashikueshëm.

Në planin politik, ajo ka kontribuar në rritjen e euroskepticizmit dhe në forcimin e narrativave nacionaliste dhe populiste. Në planin ekonomik, pasiguria rreth perspektivës evropiane ka ndikuar në uljen e investimeve të huaja direkte dhe në rritjen e emigrimit, veçanërisht të të rinjve dhe profesionistëve të kualifikuar.

Në aspektin gjeopolitik, vakumi i krijuar nga vonesa e zgjerimit ka hapur hapësirë për rritjen e ndikimit të aktorëve të tretë, si Rusia, Kina dhe Turqia, të cilët ofrojnë alternativa ekonomike dhe politike ndaj BE-së. Kjo dinamikë e re sfidon rolin tradicional të BE-së si aktori kryesor normativ në rajon.

Në këtë kontekst, analiza SWOT paraqitet si një mjet analitik i përshtatshëm për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin e integritimit evropian të BP. Në kontekstin e integritimit evropian të BP, analiza SWOT ofron një kornizë të përshtatshme për të identifikuar avantazhet strukturore të rajonit, dobësitë institucionale, mundësitë që rrjedhin nga procesi integruar dhe kërcënimet që lidhen me vonesën e anëtarësimit.

Përmes kësaj qasjeje, integrimi evropian analizohet jo vetëm si proces normativ, por edhe si proces strategjik, i ndikuar nga faktorë politikë, ekonomikë dhe gjeopolitikë. Analiza SWOT mundëson një vlerësim kritik dhe gjithëpërfshirës, duke krijuar bazë për rekomandime konkrete politike në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit eurointegruar.

Kjo qasje mundëson identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në përparimin e integritimit, duke ofruar një kornizë të strukturuar për analizë krahasuese dhe për formulimin e rekomandimeve politike.

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë procesin e integritimit evropian të BP përmes analizës SWOT, duke u fokusuar në ndikimin e vonesës së anëtarësimit në zhvillimin politik, institucional dhe socio-ekonomik të rajonit. Përmes kësaj analize synohet të ofrohet një pasqyrë kritike mbi gjendjen aktuale të procesit eurointegruar, si dhe të identifikohen rrugë alternative për rritjen e efektivitetit dhe besueshmërisë së politikës së zgjerimit të BE-së.

2. MATERIALE DHE METODAT

Kjo analizë krahasuese synon të identifikojë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet shteteve të BP në kontekstin e vonesës së anëtarësimit në BE, duke u mbështetur në komponentët e analizës SWOT.

Të gjitha shtetet e BP ndajnë një orientim strategjik drejt BE, i cili përbën një forcë të përbashkët në procesin eurointegruar. Megjithatë, s'duhet nënvlerësuar faktin se BP po fiton rëndësi më të madhe gjeopolitike për shkak të rivalitetit në rritje të fuqive në këtë rajon (Krzyszowski, 2023:188).

Intensiteti dhe konsistenca e reformave ndryshon nga një shtet në tjetrin. Mali i Zi dhe Serbia dallohen për avancimin më të madh formal në negociata, çka reflekton kapacitete më të zhvilluara administrative. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë treguar progres në reforma kyçe, veçanërisht në drejtësi dhe administratë, por janë ndikuar nga bllokime politike dhe faktorë të jashtëm. Pritet të shihet se si Maqedonia e Veriut do të merret me kapjen e shtetit, gje kjo që reflekton mangësi specifike insitucionale dhe sociale (Imeri & Azizi, 2024). Bosnje dhe Hercegovina dhe Kosova përballen me kufizime më të theksuara institucionale, çka e dobëson pozicionin e tyre krahasues në aspektin e forcave (EC, 2023). Në rastin e Kosovës, ka pasur një përkeqësim të vazhdueshëm në njohjen e pavarësisë së Kosovës (Imeri & Azizi, 2023). Përparësitë ekzistojnë në të gjitha shtetet, por janë të pabarabarta dhe të kushtëzuara nga kapacitetet institucionale dhe stabiliteti politik. Nuk ka asnjë argument se si ndryshimet legjislative do të kontribuojnë në eliminimin e problemeve themelore siç janë: politizimi dhe klientelizmi, cilësia e dobët e procesit të hartimit të politikave, pasiguria ligjore etj (Azizi et al., 2023:47).

Dobësitë paraqesin elementin më homogjen në analizën krahasuese. Ashtu si vendet e tjera në tranzicion, shumë ligje u miratuan për një kohë të shkurtër dhe, si rezultat, nuk ka një shqyrtim realist për ndikimin e tyre në praktikë, por janë gjetur edhe mangësi serioze në zbatim për shkak të mungesës ose funksionimit të dobët të institucioneve (Azizi, 2015:714). Nuk ka asnjë argument se si ndryshimet legjislative do të kontribuojnë në eliminimin e problemeve themelore siç janë: politizimi dhe klientelizmi, cilësia e dobët e procesit të hartimit të politikave, pasiguria ligjore etj (Azizi et al., 2023:47). Të gjitha shtetet përballen me probleme të sundimit të ligjit dhe

korupsionit, megjithëse në nivele të ndryshme. Politizimi i institucioneve dhe mungesa e konsensusit politik janë më të theksuara në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Kapacitetet administrative janë më të konsoliduara në Mali të Zi dhe Serbi, ndërsa më të dobëta në shtetet me struktura shtetërore komplekse. Dobësitë janë strukturore dhe rajonale, por intensiteti i tyre ndryshon nga një shtet në tjetrin, duke ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e integritimit (EC Rule of law, 2022). Ndoshta, duhet të krijohet një sistem i përkohshëm ndërkombëtar gjyqësor dhe prokurorial (i udhëhequr nga BE-ja) për të zgjidhur raste serioze që përfshijnë zyrtarë të lartë politikë të qeverisë (Azizi et al., 2022:17)

Mundësitë që ofron procesi eurointegruar janë të njëjta për të gjitha shtetet, por aftësia për t'i shfrytëzuar ato ndryshon ndjeshëm (Azizi, 2008). Shtetet me institucione më funksionale kanë shfrytëzuar më mirë fondet e para-anëtarësimit (EC, 2022). Bashkëpunimi rajonal përbën mundësi të rëndësishme, por tensionet bilaterale e kufizojnë atë në disa raste. Integrimi sektorial gradual (energji, treg, digjitalizim) paraqet potencial të madh për të gjitha shtetet. Mundësitë janë të përbashkëta, por realizimi i tyre varet nga kapacitetet e brendshme dhe vullneti politik i secilit shtet. E ardhmja e BP në BE varet nga një angazhim i dyfishtë - si nga rajoni për të vazhduar ndjekjen e reformave, ashtu edhe nga BE-ja për të ruajtur hapjen e saj ndaj zgjerimit të mëtejshëm (Tubič, 2025:207). Ashtu si vendet e tjera në tranzicion, shumë ligje u miratuan për një kohë të shkurtër dhe, si rezultat, nuk ka një shqyrtim realist për ndikimin e tyre në praktikë, por janë gjetur edhe mangësi serioze në zbatim për shkak të mungesës ose funksionimit të dobët të institucioneve (Azizi, 2015:714).

Kërcënimet janë të përbashkëta për të gjitha shtetet e BP, por ndikimi i tyre është i diferencuar. Euroskepticismi dhe humbja e besimit publik janë më të dukshme në shtetet me procese të bllokuara. Ndikimi i aktorëve të jashtëm është më i theksuar në shtetet me pasiguri politike dhe institucionale. Emigrimi dhe stagnimi ekonomik prekin të gjithë rajonin, por me intensitet të ndryshëm. Kërcënimet janë rajonale dhe afatgjata, por kapaciteti i shteteve për t'i menaxhuar ato është i pabarabartë (EC, 2021)

Pyetja kryesore hulumtuese për sa i përket këtij punimi shkencor është: Si mund të vlerësohet procesi eurointegruar i BP përmes analizës SWOT në kushtet e vonës së anëtarësimit në BE?

3. REZULTATET

Per nevojat e këtij studimi kemi realizuar një SWOT analize.

Tabela 1. SWOT analiza e përbashkët mbi vonesën në eurointegrimin e vendeve të BP

Përparësitë	• Perspektiva evropiane njihet zyrtarisht nga BE-ja për të gjitha vendet e BP
	• Ekziston një kornizë e qartë për procesin e integritimit evropian dhe përafrimin gradual me <i>acquis communautaire</i>
	• Përvojat e nevojshme janë krijuar përmes reformave institucionale dhe administrative të orientuara drejt BE-së
	• Ekziston mbështetje formale për integrimin evropian nga shumica e elitave politike dhe qytetarëve
	• Pozicioni gjeostrategjik i rajonit është i rëndësishëm për stabilitetin dhe sigurinë evropiane
Sfidat	• Ka kapacitete të kufizuara institucionale për zbatimin efektiv të reformave
	• Ka korupsion dhe sundim të dobët të ligjit që po ngadalëson progresin real
	• Ka politizim të reformave dhe mungesë konsensusi politik
	• Procesi varet nga faktorë të jashtëm dhe nuk është plotësisht nën kontrollin e vetë vendeve kandidatë
	• Ka lodhje të brendshme nga reformat për shkak të mungesës së rezultateve konkrete
Mundësitë	• Periudha e vonës duhet të përdoret për të bërë reforma cilësore, jo vetëm përmbushjen formale të kritereve
	• Bashkëpunimi rajonal duhet të rritet në përgatitje për tregun e brendshëm të BE-së
	• Fondet e para-anëtarësimit (IPA) duhet të përdoren për zhvillimin ekonomik dhe ndërtimin e kapaciteteve.
	• Rezistenca institucionale ndaj krizave të brendshme dhe të jashtme duhet të forcohet
	• Përshtatja ndaj politikave sektoriale të BE-së duhet të bëhet gradualisht, madje edhe para anëtarësimit të plotë
Rreziqet	• Ndikimi i aktorëve jashtë BE-së me interesa gjeopolitike konkurruese mund të rritet
	• Ekonomia mund të ngecë dhe emigrimi i të rinjve dhe profesionistëve mund të rritet
	• Regresioni demokratik dhe praktikatat autoritare mund të jenë në rrezik
	• Marrëdhëniet rajonale mund të destabilizohen për shkak të konflikteve të pazgjidhura

	• Besimi i qytetarëve në procesin e integrimit evropian mund të humbasë dhe euroskepticizmi po rritet
--	---

Burimi: Hulumtimi nga autorët

Analiza SWOT dëshmon se procesi eurointegruar i BP karakterizohet nga një pabarazi strukturore ndërmjet shteteve, ku forcat dhe mundësitë ekzistuese nuk arrijnë të kompensojnë plotësisht dobësitë dhe kërcënimet e prodhuara nga vonesa e anëtarësimit. Si rezultat, eurointegrimi zhvillohet në mënyrë asimetrike dhe me ritme të ndryshme ndërmjet shteteve të rajonit (EC Annual Report, 2022). Mundësitë që ofron procesi eurointegruar janë të njëjta për të gjitha shtetet, por aftësia për t'i shfrytëzuar ato ndryshon ndjeshëm (Azizi, 2008).

Më poshtë është një analizë SWOT me fjalë të plota për secilin shtet të BP lidhur me vonesën e eurointegrit.

Tabela 2. SWOT analiza e veçantë mbi vonesën në eurointegrimin për vendet e BP

Shteti	Përparësitë	Mangësitë	Mundësitë	Rreziqet
Shqipëria	Mbështetje e lartë publike për integrim në BE dhe orientimi strategjik për përbushjen e kriterëve	Kapacitetet administrative dhe institucionale janë të kufizuara, ndërsa korrupsioni dhe politizimi pengojnë zbatimin efektiv të reformave	Mund të shfrytëzojë fondet IPA dhe instrumentet e BE-së për zhvillim ekonomik dhe konsolidim institucional, si dhe të thellojë bashkëpunimin rajonal	Vonesa e integrimit rrit pasigurinë politike, euroskepticizmin dhe mund të nxisë emigrimin e të rinjve dhe ndikimin e aktorëve të jashtëm
Mali i Zi	Përparim i konsiderueshëm formal në negociata dhe institucione administrative relativisht të konsoliduara.	Politizimi i institucioneve dhe korrupsioni mbeten sfida kryesore për konsolidimin e reformave.	Vonesa mund të përdoret për integrim gradual sektorial dhe forcim të bashkëpunimit rajonal, duke shfrytëzuar përfitimet e BE-së.	Ndikimi i aktorëve gjeopolitikë jashtë BE-së, euroskepticizmi dhe emigrimi i të rinjve.
Serbia	Kapacitete administrative të zhvilluara dhe një pozicion i fortë formal në negociatat me BE-në.	Çështjet bilaterale me Kosovën dhe ndikimi i vendeve si Rusia dhe Kina kufizojnë avancimin e procesit.	Përdorimi i instrumenteve të BE-së për integrim gradual sektorial dhe rritje të bashkëpunimit ekonomik rajonal.	Devijimi strategjik nga orientimi evropian dhe tensionet rajonale që kërcënojnë stabilitetin.
Maguedonia e Veriut	Marrëveshja e Prespës dhe harmonizimi ligjor kanë forcuar potencialin për integrim.	Krizat politike të brendshme dhe vetot e vendeve anëtare ndikojnë negativisht në ritmin e reformave.	Mund të përdoret për integrim gradual sektorial dhe thellim të bashkëpunimit rajonal.	Nacionalizmi dhe mosmarrëveshjet etnike pengojnë përparimin e procesit eurointegruar.
Hercegovia dhe	Potencial evropian ekzistues dhe mbështetje ndërkombëtare për procesin eurointegruar.	Struktura shtetërore e fragmentuar dhe polarizimi politik e bëjnë të vështirë implementimin e reformave.	Mund të shfrytëzojë reforma kushtetuese dhe mbështetje nga BE për përmirësimin e funksionimit institucional.	Konfliktet etno-politike dhe bllokadat institucionale pengojnë përparimin dhe rrisin pasigurinë rajonale.
Kosova	Orientim strategjik drejt BE-së dhe përkushtim i lartë për reforma demokratike.	Kapacitetet administrative janë të kufizuara dhe mungesa e njohjes ndërkombëtare krijon pengesa shtesë.	Mund të përfitojë nga liberalizimi i vizave, instrumentet financiare të BE-së dhe bashkëpunimi rajonal.	Euroskepticizmi, ndikimi i aktorëve të jashtëm dhe pasiguria politike mund të ngadalësojnë progresin eurointegruar.

Burimi: Hulumtimi nga autorët

Analiza SWOT tregon se vendet e BP ndajnë sfida dhe mundësi të përbashkëta, por edhe dallime në kapacitetet institucionale, stabilitetin politik dhe vullnetin për reforma, të cilat ndikojnë në krijimin e trajektoreve të ndryshme

të integritimit evropian. Vonesa në anëtarësim po e thellon gjithashtu këtë divergjencë dhe po rrit rrezikun e fragmentimit rajonal.

4. DISKUTIME

Pyetja kryesore e këtij studimi kishte për qëllim të vlerësonte se si mund të analizohet procesi eurointegruar i BP përmes qasjes SWOT në kushtet e vonesës së anëtarësimit. Rezultatet tregojnë se analiza SWOT ofron një kornizë të përshtatshme metodologjike për të identifikuar ndërveprimin ndërmjet faktorëve të brendshëm (perparesite dhe dobësitë) dhe faktorëve të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet), duke nxjerrë në pah natyrën komplekse dhe asimetrike të procesit eurointegruar në rajon.

Gjetjet konfirmojnë se, ndonëse të gjitha shtetet e BP ndajnë një orientim strategjik drejt BE, vonesa e anëtarësimit ka prodhuar trajektore të ndryshme zhvillimi, të ndikuara nga kapacitetet institucionale, stabiliteti politik dhe vullneti reformues i secilit shtet.

Me poshte kemi realizuar një diskutim të hipotezave.

Hipoteza e parë supozon se vonesa e anëtarësimit në BE ka ndikim negativ në efektivitetin e reformave politike dhe institucionale. Analiza e rezultateve e mbështet këtë hipotezë, duke treguar se mungesa e një perspektive të qartë dhe të besueshme anëtarësimi ka ndikuar në uljen e motivimit për reforma të thella dhe të qëndrueshme. Në disa shtete, kjo situatë ka favorizuar zbatimin formal të reformave, pa prodhuar ndryshime substanciale në praktikën institucionale. Diskutimi i këtij rezultati sugjeron se kushtrimi evropian humb efektivitetin e tij nëse nuk shoqërohet me stimuj të qartë politikë dhe përfitime konkrete, duke e kthyer procesin eurointegruar nga një mekanizëm transformues në një proces administrativ.

Hipoteza e dytë thekson rolin përcaktues të dobësive strukturore të brendshme në stërzgjatjen e procesit eurointegruar. Gjetjet e analizës SWOT e konfirmojnë këtë hipotezë, duke evidentuar se problemet e sundimit të ligjit, korrupsioni dhe politizimi i institucioneve përbëjnë pengesa të përbashkëta për të gjitha shtetet e BP, pavarësisht nivelit formal të avancimit në proces. Nga pikëpamja metodologjike, ky rezultat nënvizon rëndësinë e analizës së faktorëve të brendshëm si elementë kyç në vlerësimin e suksesit të eurointegritimit, duke sugjeruar se progresi formal nuk është gjithmonë tregues i reformave reale.

Hipoteza e tretë parashikon se periudha e vonesës së anëtarësimit krijon mundësi për konsolidimin e reformave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Rezultatet tregojnë se kjo hipotezë konfirmohet vetëm pjesërisht. Ndërsa ekzistojnë instrumente dhe mekanizma që mundësojnë thellimin e reformave dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal, shfrytëzimi i tyre mbetet i pabarabartë ndërmjet shteteve. Diskutimi i këtij rezultati tregon se vonesa e integritimit nuk prodhon automatikisht efekte pozitive; përkundrazi, ajo kërkon një nivel të lartë të vullnetit politik dhe kapacitete institucionale për t'u shndërruar në mundësi zhvillimi.

Hipoteza e katërt trajton rritjen e kërcënimeve gjeopolitike dhe rrezikun e regresit demokratik si pasojë e vonesës së integritimit. Analiza SWOT e mbështet këtë hipotezë, duke treguar se mungesa e progresit të dukshëm drejt anëtarësimit krijon hapësirë për rritjen e ndikimit të aktorëve të jashtëm dhe për dobësimin e standardeve demokratike në rajon. Ky rezultat sugjeron se eurointegrimi nuk është vetëm një proces teknik apo politik, por edhe një faktor stabiliteti dhe sigurie për BP.

Nga aspekti metodologjik, përdorimi i analizës SWOT rezulton efektiv për vlerësimin krahasues të procesit eurointegruar, pasi lejon një analizë gjithëpërfshirëse të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Megjithatë, rezultatet tregojnë se kjo qasje duhet të kombinohet me analiza të thelluara cilësore për të shmangur thjeshtësimin e tepërt të fenomeneve komplekse politike dhe institucionale.

Në përmbledhje, diskutimi i rezultateve tregon se vonesa e anëtarësimit në BE ka një ndikim të shumëanshëm dhe kryesisht negativ në procesin eurointegruar të shteteve të BP. Ndërsa ekzistojnë forca dhe mundësi që mund të shfrytëzohen për avancimin e reformave, dobësitë strukturore dhe kërcënimet e jashtme vazhdojnë të mbizotërojnë, duke e bërë të domosdoshme një qasje më koherente dhe strategjike nga ana e aktorëve vendorë dhe evropianë.

Verifikimi i hipotezave hulumtuese

Hipoteza 1: Vonesa e anëtarësimit në BE ka një ndikim negativ në efektivitetin e reformave politike dhe institucionale në shtetet e BP. Kjo hipotezë konfirmohet plotësisht sepse analiza SWOT tregon se mungesa e një perspektive të qartë anëtarësimi ka dobësuar motivimin për reforma të thella dhe ka kontribuar në politizimin e proceseve reformuese. Dobësitë e identifikuar në sundimin e ligjit dhe kapacitetet institucionale janë përforcuar nga vonesa e integritimit.

Hipoteza 2: Dobësitë strukturore të brendshme përbëjnë pengesën kryesore për avancimin e procesit eurointegruar të shteteve të BP. Kjo hipotezë konfirmohet plotësisht sepse gjetjet tregojnë se, pavarësisht dallimeve ndërmjet shteteve, problemet e përbashkëta strukturore – korrupsioni, politizimi i institucioneve dhe kapacitetet administrative të kufizuara – përbëjnë faktorë përcaktues në stërzgjatjen e procesit eurointegruar.

Hipoteza 3: Periudha e vonesës së anëtarësimit krijon mundësi për konsolidimin e reformave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Kjo hipoteze konfirmohet pjesërisht sepse analiza SWOT evidenton se vonesa ofron potencial për thellimin e reformave dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal; megjithatë, shfrytëzimi i këtyre mundësive mbetet i pabarabartë dhe i kushtëzuar nga vullneti politik dhe kapacitetet institucionale të secilit shtet.

Hipoteza 4: Vonesa e integritimit rrit kërcënimet gjeopolitike dhe rrezikun e regresit demokratik në BP. Kjo hipoteze konfirmohet plotësisht sepse analiza tregon se rritja e ndikimit të aktorëve të jashtëm, euroskepticizmi dhe emigrimi janë kërcënime të përbashkëta që intensifikohen në kushtet e mungesës së një perspektive të besueshme evropiane.

Bazuar në verifikimin e hipotezave:

- Konfirmimi i H1 dhe H2 justifikon nevojën për reforma strukturore të thelluara dhe depolitizim institucional në shtetet e BP.
- Konfirmimi i pjesshëm i H3 nënvizon domosdoshmërinë e qasjes diferencuese të BE-së dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal.
- Konfirmimi i H4 mbështet rekomandimet për rritjen e angazhimit strategjik të BE-së në rajon për të parandaluar regresin demokratik dhe destabilizimin gjeopolitik.

5. KONKLUZA

Analiza krahasuese përmes qasjes SWOT tregon se procesi eurointegruar i shteteve të BP karakterizohet nga një kombinim i forcave dhe dobësive strukturore, të cilat ndikohen ndjeshëm nga vonesa e anëtarësimit në BE. Megjithatë të gjitha shtetet ndajnë një orientim strategjik drejt BE-së dhe janë të përfshira në mekanizma formal të integritimit, ritmi dhe cilësia e reformave mbeten të pabarabarta ndërmjet tyre.

Dobësitë e përbashkëta, si sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni dhe politizimi i institucioneve, përbëjnë pengesa kryesore për avancimin e procesit eurointegruar. Vonesa e anëtarësimit ka kontribuar në zbehjen e besueshmërisë së perspektivës evropiane, duke ulur motivimin për reforma të thella dhe duke rritur rrezikun e regresit demokratik në disa shtete.

Nga ana tjetër, analiza evidenton se periudha e vonesës përmban edhe mundësi të rëndësishme, veçanërisht për konsolidimin e reformave, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe integrimin gradual në politikat sektoriale të BE-së. Megjithatë, këto mundësi nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të barabartë, kryesisht për shkak të kapaciteteve të ndryshme institucionale dhe mungesës së vullnetit politik.

Kërcënimet e përbashkëta, përfshirë rritjen e euroskepticizmit, emigrimin masiv dhe ndikimin e aktorëve të jashtëm, paraqesin rreziqe afatgjata për stabilitetin politik, ekonomik dhe demokratik të rajonit. Në mungesë të një perspektive të qartë dhe të besueshme anëtarësimi, ekziston rreziku i fragmentimit të procesit eurointegruar dhe divergjencës së mëtejshme ndërmjet shteteve të BP.

Lidhja ndërmjet pyetjeve hulumtuese, hipotezave dhe analizës SWOT tregon se vonesa e anëtarësimit nuk është vetëm një çështje procedurale, por një faktor strukturor që ndikon drejtpërdrejt në trajektoren politike, institucionale dhe shoqërore të shteteve të BP. Një qasje më koherente dhe e besueshme nga ana e BE-së, e kombinuar me reforma të thella të brendshme, mbetet thelbësore për suksesin e procesit eurointegruar.

BIBLIOGRAFIA

- Azizi, A. & Ceka-Neziri, L. (2023). Evaluation of Public Administration Reforms in North Macedonia from the perspective of European Commission's Annual Progress Reports. *Hrvatska i komparativna javna uprava*, 23 (1), 35-60.
- Azizi, A. (2008). Reformat e administratës publike në Republikën e Maqedonisë drejt integritimit evropian. In: Shteti i së drejtës dhe reformat në AP: Rasti Maqedoni. No. 6/2008, pp. 57–78. CRPA.
- Azizi, A. (2013). European Union integration of Macedonia: Negotiation for membership. *International Journal of Social Sciences and Humanity Studies*, 5(1).
- Azizi, A. (2015). Economic criteria for EU membership and legislation on economic reforms in Macedonia. *Procedia Economics and Finance*, 26, 709–716
- Azizi, A. (2022). New states in international relations: Foreign policy analysis of North Macedonia and Kosovo. Në *Crises and creative destruction: Opportunity for re-modeling the economy and society*. UET Press, 127–135
- Azizi, A., & Neziri-Ceka, L. (2022). Rule of law in the Republic of Macedonia over the last decade evaluated by international authorities. *Balkan Social Science Review*, 20, 7–27.
- Azizi, A., & Neziri-Ceka, L. (2023). Evaluation of public administration reforms in North Macedonia from the perspective of European Commission's annual progress reports. *Croatian and Comparative Public Administration*, 35–60.
- Azizi, A., Aziri, E., & Elezi, Z. (2009). Fjalor shumë dimensional i termave dhe shprehjeve administrative, politike, sociale dhe të diplomacisë. Vatra.

- European Commission. (2022). Report on the Rule of Law and Governance in the Western Balkans. Bruxelles: European Commission.
- European Commission. (2022). The Western Balkans in the European Union: Annual Report 2022.
- European Commission. (2022). Western Balkans at a Crossroads: Progress and Challenges in EU Integration. Bruxelles: European Commission.
- European Commission. (2022). Western Balkans: European Perspective. Raport i publikuar nga Komisioni Evropian mbi progresin dhe sfidat e rajonit.
- European Commission. (2023). Western Balkans and the European Union: Annual Report on Progress. Bruxelles: European Commission.
- European Union. (2021). Western Balkans: A region in transition. Bruxelles: European Union.
- Imeri, D., & Azizi, A. (2023). Structural and non-structural obstacles in the process of recognition of independence of Kosovo: 2008–2021. *Journal of Liberty and International Affairs*, 352–363
- Imeri, D., Azizi, A.(2024). A dream or a dread? Perception of the North Macedonian youth on European integration. *Në: Imagining Europe in times of war and crises: Youth perceptions from Balkans* Springer. 81–98
- Krzyszowski, A. (2023). Western Balkans Geopolitical Significance: The United Arab Emirate's Perspective. *Balkan Social Science Review*, 21(21), 167-197
- Tubić, B. (2025). EU and Western Balkan Countries. *Law, Identity and Values*, 5(2), 191–213.